



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.736/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelet e subjekteve politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj si dhe Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), të paraqitura kundër vendimit me numër 860-2021 i datës 04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, që ka të bëjë me shpalljen e rezultatit përfundimtar i publikuar me datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e Panelit, të mbajtur më datë 10.03.2021, mori këtë:

V E N D I M P L O T Ë S U E S

PLOTËSOHET Vendimi A.nr.736/2021 i datës: 07.03.2021 si në vijim:

I. PRANOHEN pjesërisht të bazuara apelet Anr.736/2021 i datës 05.03.2021, e paraqitura nga subjektet politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), me seli në Ferizaj dhe apeli Anr.769/2021 i datës 05.03.2021, i paraqitur nga Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), anulohen 40 fletëvotime Vendvotimin (VV) 3502D/01R në Komunën e Ranillug, që i përkasin subjektit politik Romani Iniciativa.

II. REFUZOHEN të pabazuara apelet Anr.736/2021 i datës 05.03.2021, e paraqitura nga subjektet politike Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj dhe apeli Anr.769/2021 i datës 05.03.2021, i paraqitur nga Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) në pjesën që ka kërkuar që të anulohen fletëvotimet në raport me subjektin politik Romani Iniciativa, në Vendvotimet: 3803B/01R, 3805B/02R, 3805B/03R, 3805B/04R, 3805B/06R, 3805B/07R, 3805B/08R, 3805B/09R, 3805B/10D, 380X/01R, 3805X/02R, 3805X/04R, 3805X/05R, 3805X/06D, 3806B/01D.

A r s y e t i m

Paneli, me vendimin A.nr.736/2021 i datës 07.03.2021, në pikën I. të dispozitivit ka vendosur që të pranohen pjesërisht si të bazuara apelet e subjekteve ankuese, në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të Urdhërohet KQZ-ja, që fletëvotimet e anuluar në për vendvotimet e theksuara si në pikën -I- të dispozitivit të vendimit, ti largoj nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës i publikuar me vendimin Nr.860-2021 I datës 04.03.2021, ndërsa në pikën -III-, ka vendosur që të refuzohen pjesërisht si të pa bazuara apelet e palës ankuese, duke vendosur më decidivisht si në pikën I, II dhe III të dispozitivit të vendimit të datës 07.03.2021.

Paneli, me rastin e përgjigjes në ankesën e subjekteve ankuese në Gjykatën Supreme, ka konstatuar se për një pjesë të ankesës së subjekteve ankuese nuk është vendosur me vendimin e datës 07.03.2021, e të atakuar në Gjykatën Supreme të Kosovës, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, me rastin e vendosjes nuk e vlerësoi si të nevojshme që në këtë aktvendim ti referohet edhe njëherë arsyetimit të fakteve me rëndësi për të vendosur lidhur me këtë çështje, për arsye se arsyetimi i mënyrës së vendosjes si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, është përfshirë në vendimin e datës 07.03.2021.

Paneli, me rastin e vendosjes nuk e vlerësoi si të nevojshme që në këtë aktvendim ti referohet edhe njëherë arsyetimit të fakteve me rëndësi për të vendosur lidhur me këtë çështje, për arsye se arsyetimi i mënyrës së vendosjes për pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, është përfshirë në vendimin e datës 07.03.2021, në pjesën refuzuese i cili vlen edhe për pikën -II-, të vendosur me këtë vendim plotësues.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafët 2 dhe 3, neni 119 paragrafi 5, neni 120 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.736/2021 më datë 10.03.2021

Kryesuesi i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa, brenda afatit 24 orë nga dita e pranimi, në Gjykatën Supreme.